



BALLINA

LAJME

VIDEO

BOTA

SPORT

OPINION

SHOWBIZ


LIFESTYLE

AUTO & TEK

FUN

ENGLISH

Policia gjen sërish armatim, municion dhe radiolidhje në veri të Mitrovicës



21/11/2024 15:07



Policia e Kosovës ka njoftuar se pas pranimit të informatës mbi dyshimet për armë dhe municion, njësitë policore kanë ndërmarrë veprimet e menjëhershme ku janë kryer kontrolle në rrugën “Kralj Petri” në veri të Mitrovicës.

Me këtë rast, Policia ka njoftuar se gjatë kontrollit nën një kalim të ndërtesës janë gjetur, municion dhe pajisje të ndryshme, transmeton lajmi.net.

Dëshmitë të cilat janë gjetur dhe janë konfiskuar janë:

1. një AK-47
2. pesë karikatorë me municion të AK 47
3. 136 fishekë të AK- 47
4. një çantë krahu
5. dy radio-lidhje të dorës
6. një radio lidhje për veturë
7. dy mbushës radiolidhjesh
8. një tytë shtesë e AK-47


“Deri në këtë fazë të hetimeve janë kryer disa intervistime të personave në këtë ndërtesë ku të gjitha veprimet e mëtejme do të ndërmerren në bashkëpunim dhe koordinim me organet e drejtësisë”,thuhet në njoftimin për media.

Duhet përkujtuar që gjatë dy ditëve të fundit policia pati disa raste të gjetjes dhe sekuestrimit të armëve në veri të vendit./Lajmi.net/



Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LeposMedia



Artikuj të ngjashëm



November 21, 2024
Kurti: USAID na ka mbështetur në reformat e qeverisë




November 21, 2024
Incidenti me armë zjarri në Prishtinë, Arifi: Siguria publike çdo ditë...



November 21, 2024
Incidenti në Kodrën e Trimave- Policia shihet edhe në QKUK, po...



November 21, 2024
Mushkolaj: Serbia me shumë mund e ka penguar Asociacionin



November 21, 2024
SHBA vendos sanksione të reja kundër Rusisë



November 21, 2024
Policia e Kosovës demanton shkrimet e mediave serbe mbi shkeljen e...

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information